

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “FREISO INTERNATIONAL “ SHPK

Në Tiranë, sot më datë 04.09.2025, ne të poshtëshënuarit:

- Mateo Hysaj i datelindjes 26.09.1994, shtetas Shqiptar , mbajtes i ID Nr. J40926050V
- Nertila Latifi e datelindjes 16.01.1985, shtetase Shqiptare , mbajtese e ID Nr. I55116010R
- Elis Angjellari e datelindjes 02.04.1988, shtetase Shqiptare , mbajtese e ID Nr. I85402058J

me cilësinë e “ortakeve themelues” deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**FREISO INTERNATIONAL “ shpk**

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**FREISO INTERNATIONAL “ sh.p.k** , dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria e ka seline në adresë:

- Tirane Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Sh/K.10, 1023

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Kompania do të kryejë aktivitetin si më poshtë me kete objekt:

Aktivitetet e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar, të kryera me mjete transporti të palëve të treta me rrugë tokësore, detare, ujore dhe ajrore.

- Ndermjetesim transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira.
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e logjistikës.
- Ushtrimi i veprimtarisë si agjenci doganore, agjenci spedicionere, si dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën doganore dhe të transportit.
- Të kryejë aktivitet tregtar si agent transportues, spedicioni dhe transporti, si dhe të veprojë si agent zhdoganimi.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë veprimtari import-eksporti me vendet e Bashkimit Europian (EU) dhe vendet jo anëtare të BE-së (NON-EU).

- Për të përmbushur objektin e saj, shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin në të gjitha vendet dhe në çdo formë apo modalitet që do ta konsiderojë më të përshtatshëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm është nënshkruar nga "ortaket "e shoqërisë :

- Mateo Hysaj, zoterues i 1 kuote që perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.
- Nertila Latifi zoteruese e 1 kuote që perben 34 % te kapitalit themeltar te shoqërisë
- Elis Angjellari zoteruese e 1 kuote që perben 33 % te kapitalit themeltar te shoqërisë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtuishme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqërisë;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

- Mateo Hysaj i datelindjes 26.09.1994, shtetas Shqiptar, mbajtes i ID Nr. J40926050V emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarete dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.


Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues të shoqërisë tregtare “**FREISO INTERNATIONAL** “ shpk,nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

Mateo Hysaj



Nertila Latifi



Elis Angjellari

